

Nr. 225. prot
Data 25. 7. 2019

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

midis

**Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë
Kibernetike**

dhe

Akademisë së Studimeve Politike

mbi

bashkëpunimin për zbatimin e programeve të kërkimit dhe
ndërgjegjësimit me qëllim krijimin e një mjedisi të sigurt online

I. Hyrje

Duke pasur parasysh se **Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK)** dhe **Akademia e Studimeve Politike (ASP)** kanë objektiv të përbashkët:

- Edukimin dhe ndërgjegjësimin e të rinjve dhe qytetarëve në përgjithësi, mbi parimet kryesore të qeverisjes së mirë si shteti i së drejtës, legjitimiteti, transparenca, llogaridhënia, aksesueshmëria dhe respekti për të drejtat e njeriut;
- Ndërtimin e mekanizmave për evidentimin e risqeve dhe grupeve e individëve vulnerabel ndaj tyre, me qëllim krijimin e një mjedisi të sigurt online në Shqipëri;
- zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik duke krijuar shanse të barabarta për mirëqënien dhe sipërmarrjen e lirë të qytetarëve;

Të dyja palët kanë vendosur se është në interesin më të mirë të tyre të punojnë së bashku për zbatimin e programeve të ndryshme të kërkimit dhe ndërgjegjësimit me qëllim krijimin e një mjedisi të sigurt online.

II. Qëllimi i Bashkëpunimit

Qëllimi i këtij Memorandumi është bashkëpunimi i dy institucioneve në kuadër të thirrjes për aplikime (NOFO) të Ambasadës Amerikane në Tiranë, për iniciativat e shoqërisë civile lidhur me përballimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Më konkretisht:

- në bashkërendimin e ekspertizës në organizmin e aktiviteteve të përbashkëta për edukimin e të rinjve me qëllim identifikimin e elementeve kontaminues që qarkullojnë në internet dhe çënojnë sigurinë kibernetike në vend;
- nxitjen e dialogut me aktorëve të ndryshëm vendimmarrës për përmirësime në kuadrin ligjor rregullues të fushës, për të rritur nivelin e sigurisë kibernetike në vend.
- përfshirjen në trajnime dhe aktivitete të tjera të organizuara të të rinjve dhe aktorëve të tjerë nga grupet vulnerabël me qëllim ndërgjegjësimin e tyre ndaj rreziqeve online;
- Bashkëpunimin për hartimin e programeve të trajnimit dhe materialeve të ndryshme informuese dhe ndërgjegjësuese në lidhje me sigurinë kibernetike dhe rezistencën ndaj radikalizimit online;

III. Kuadri i Bashkëpunimit

Të dyja institucionet bien dakord që qëllimi i bashkëpunimit në këtë marrëveshje është brenda misionit të tyre të përbashkët dhe bashkërendimi i energjive, eksperiencës dhe mundësive financiare, është një hap pozitiv drejt realizimit të objektivave të tyre.

Organizmat vazhdojnë të mbetet të lira dhe të pavarura në misionin e tyre edhe pas kësaj marrëveshjeve bashkëpunimi.

Palet bien dakort te kryejne hapat konkrete për realizimin e këtij bashkëpunimi duke përfshirë:

- dorëzimin zyrtar të rekomandimeve që kanë për qëllim rregullime të kuadrit ligjor për rritjen e sigurisë kibernetike;
- angazhimin e përbashkët për zbatimin e këtyre rekomandimeve në ndryshimet e pritshme të kuadrit ligjor në këtë sektor;

- bashkëpunimi për përdorimin e ekspertizës profesionale dhe materialeve edukuese me qëllim përdorimin e tyre në trajnimet dhe aktivitetet e tjera të programit;
- bashkërendimi i fushatave publike të sensibilizimit dhe në materialet promovuese drejtuar publikut të gjerë;

IV. Hyrja Ne Fuqi

Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi me nënshkrimin e Palëve.

**Autoriteti Kombëtar për Certifikimin
Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike**

Vilma TOMCO
Drejtor i Përgjithshëm



Datë: 25.7.2019

Akademia e Studimeve Politike

Erjon TASE
Drejtor Ekzekutiv

Datë: 25.07.2019

